

NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 NË PUNONJËSIT E SEKTORIT TË ARSIMIT

Autore: Safa Xhigoli

Data: Janar 2021

Publikuar nga:

Qendra për Politika dhe Avokim

www.qpa-rks.org

info@qpa-rks.org

+383 (0) 38 226 530

Të drejtat e autorit © 2021. Qendra për Politika dhe Avokim. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 NË PUNONJËSIT E SEKTORIN TË ARSIMIT

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	2
IMPAKTI FINANCIAR.....	2
IMPAKTI PROFESIONAL.....	5
IMPAKTI PSIKOLOGJIK.....	7
KRAHASIM.....	9

HYRJE

Koronavirusi i ri Covid-19, shkaktoi parregullsi të mëdha nëpër botë. Qeveritë nëpër botë, pa përjashtuar Kosovën, ndërmorën dhe implementuan masa të ndryshme si mënyrë për të ndaluar përhapjen e pakontrolluar të virusit, të cilat ndikuan në të gjithë sektorët e jetës shoqërore dhe të ekonomisë. Ndër të parët që u ndikua nga këto masa ishte sektori i arsimit. Kështu, Ministria e Arsimit dhe Shkencës njoftoi që të gjitha institucionet e arsimit do të mbylleshin, si mënyrë për parandalimin e përhapjes së virusit, më 12 mars 2020.¹ Ndërsa me 23 mars, MASHT njoftoi për implementimin e mësimin në distancë me materiale mësimore të përgatitura për t'u transmetuar në televizionin publik të Kosovës, për institucionet fillore të arsimit.² Ndërsa, pjesa tjetër u detyrua të kalonte tërësisht në mësimin online. Masat prekën rreth 450,000 nxënës dhe rreth 31,000 punonjës në sektorin e arsimit të të gjitha niveleve.³ Përderisa mësimi i jashtëzakonshëm në kohëra të konflikteve të armatosura nuk ishte fenomen i ri për Kosovën, mësimi gjatë një pandemie të këtyre përmasave, i shoqëruar me teknologji që është utilizuar për të transmetuar këtë lloj mësimi, dëshmoi se ishte në një nivel tjetër të të jashtëzakonshmes dhe të panjohurës. Mbyllja e institucioneve të arsimit dhe implementimi i mësimin në distancë, ndikoi thellësisht te punonjësit e këtij sektori, në aspekte të ndryshme, duke filluar nga ai financiar, përderisa ekonomitë u tkurrën dhe papunësia u rrit; profesional, përderisa mësimdhënësit u detyruan papritmas të transferojnë mësimin e tyre në platforma online pa përgatitje të mjaftueshme profesionale; dhe psikologjike, përderisa izolimi total mbylli njerëzit nëpër shtëpitë e tyre dhe ekonomitë e tkurrura ulën prosperitetin ekonomik.

IMPAKTI FINANCIAR

Pandemia Covid-19 la impakt të madh dhe pasoja të theksuara në ekonomitë e shteteve nëpër botë. Kosova nuk është përjashtim. OECD parashikon se për shkak të pandemisë Covid-19 ekonomia e Kosovës do të tkurret për 1.6% deri në 5.2% gjatë vitit 2020.⁴ Edhe pse impakti financiar mund të mos jetë ndjerë nga çdo shtëpi, në një numër të madh të ekonomive familjare, është ndjerë thellësisht. Sipas një raporti të UNDP-së në qershor të këtij viti, rreth 49% e shtëpive, kanë raportuar për rënie të të ardhurave si rezultat i pandemisë.⁵ Në një shtet ku 64%

¹ Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë. (2020). Marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/article/njoftim-31>

² Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë. (2020). Marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/article/njoftim-32>

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2019). Marrë nga: https://ask.rks-gov.net/media/5460/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB%20kosov%C3%AB_2019-20_gjuheshqipe.pdf

⁴ OECD. (2020). Marrë nga: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>

⁵ UNDP. (2020). Marrë nga: <https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/poverty/rapid-socio-economic-impact-assessment-of-covid-19-in-kosovo.html>

⁶ Ibid

⁷ OECD. (2020). Marrë nga: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>

e familjeve kanë të ardhura kumulative ndër 800 Euro⁶, ky fakt ka ndikuar thellësisht. Sipas një raporti të OECD-së në efektet e pandemisë Covid-19 në Kosovë, deri në qershor 2020, numri i punëkërkesve, në mes janarit dhe prillit 2020, u rrit për gjashtë herë më shumë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.⁷ Çdo sektor i ekonomisë ka përjetuar goditje financiare, ku disa sektorë janë ndikuar më shumë se të tjerët.

Sa i përket sektorit të edukimit, mënyra kryesore nëpërmjet së cilës pandemia ka ndikuar te punonjësit e këtij sektori është financiarisht nëpërmjet pagave. Kjo është e theksuar sidomos për punonjësit e sektorit privat, me theks të veçantë te punonjësit e sektorit të edukimit parafillor, punonjësit mbështetës dhe mësimdhënësit me orar të pjesshëm me kontrata të përkohshme.

Pagat e punonjësve në sektorin publik nuk ishin aq të afektuara nga pandemia dhe kjo qëndron për të gjitha nivelet e edukimit, njashtu si edhe për të gjitha divizionet tjera në kuadër të sektorit publik. Sipas një hulumtimi të drejtuar nga D4D, rreth 82% e atyre që morën pjesë në hulumtim, nga sektori publik, mohuan të jenë ndikuar nga pandemia në vendin e tyre të punës.⁸ Mësimdhënësit dhe profesorët janë paguar ashtu siç janë paguar zakonisht dhe nuk është raportuar për ndonjë problem në lidhje me dhënien e pagave. Sipas zyrës ligjore të SBASHK-ut, mësimdhënësit e të gjitha niveleve, në sektorin publik, janë paguar rregullisht, ashtu siç janë paguar para fillimit të pandemisë, pa vonesa të theksuara apo zvogëlime pagash. SBASHK-u më tutje siguron se nuk ka pasur probleme me dhënie të pagave për mësimdhënësit zëvendësues apo ato/ata me kontrata të përkohshme, po ashtu, në institutet publike arsimore. E njëjta vlen edhe për stafin administrativ apo të mirëmbajtjes dhe të gjithë punonjësit e tjerë që janë pjesë e sindikatës.⁹

Mirëpo situata e punonjësve në sektorin privat të arsimit ishte ndryshe. Njashtu si shumica e divizioneve në sektorin privat, siç raporton një hulumtim nga D4D, rreth 64% e pjesëmarrësve në hulumtim, punonjës në sektorin publik, raportojnë të jenë ndikuar negativisht nga pandemia në vendin e tyre të punës.¹⁰ Këtu përfshihen vonesa në dhënien e pagave, zvogëlime të pagave apo ndërprerje pa paralajmëruese të kontratave. Institutet arsimore private, thellësisht të varura nga pagesat e nxënësve, raportojnë për mungesë të fondeve (pagesat e nxënësve) si arsye të pamundësisë së tyre për t'i paguar punonjësit e tyre.

Institutet parafilllore arsimore private, përjetuan një goditje të madhe financiare, sepse një numër i madh i prindërve, të cilët në fillim të pandemisë nuk shkonin në punë dhe qëndruan me fëmijë në shtëpi për disa muaj, i çregjistruan fëmijët e tyre tërësisht nga këto institute.

Natyrisht, edhe ata që vazhduan regjistrimin, nuk bënë pagesat sepse fëmijët nuk shkonin rregullisht në institutet e tyre dhe nuk mbaheshin mësimet të rregullta online, pasi që arsimi parafillor ka kërkesa tjera kur vije puna të mbajtja e mësimin në distancë për ta. Mungesë e

⁸ Demokracia për Zhvillim. (2020). Marrë nga: <https://d4d-ks.org/infografikat/si-ka-ndikuar-pandemia-covid-19-ne-vendin-tuaj-te-punes/>

⁹ Shatri, Blendor. SBASHK. Intervistë.

¹⁰ Demokracia për Zhvillim. (2020). Marrë nga: <https://d4d-ks.org/infografikat/si-ka-ndikuar-pandemia-covid-19-ne-vendin-tuaj-te-punes/>

fondit do të thotë mungesë e pagave për stafin edukativ të këtyre instituteve. Rrjedhimisht, shumica e punonjësve nuk u paguan gjatë muajve të mbylljes totale dhe kontratat e shumë prej tyre u ndërpritën nga punëdhënësit e tyre. Kjo është sidomos e theksuar te institutet parafillore private të arsimit, të cilat akomodojnë një numër të madh të fëmijëve, dhe të cilat në mungesë të kërkesës u detyruan të zvogëlojnë numrin e stafit.

Në mënyrë të ngjashme edhe insitucionet para universitare e ato të universitare të arsimit privat u ballafaquan me të njëjtat probleme. Shumica e këtyre institucioneve u mundësojnë nxënësve dhe studentëve pagesat shkollore me këste. Mirëpo sipas këtyre institucioneve, posaçërisht atyre parauniversitare, pasiqë shumë prindër dhe nxënës ishin të pasigurtë për të ardhmen, një numër i madh i tyre vonuan këstet e fundit të pagesave sepse kishin vështirësi financiare ose ishin të pasigurtë se çfarë do të sillte e ardhmja, do të thotë, nëse nuk do të kishin të ardhura financiare të mjaftueshme në rast të një depresioni ekonomik. Një numër i prindërve, sipas këtyre institucioneve, gjithashtu, refuzuan të paguanin këstet e fundit pasiqë fëmijët e tyre nuk merrnin pjesë fizikisht në ambientet e shkollës dhe i shihnin mësimet virtuale si të padenja për atë pagesë, duke dyshuar në kualitetin e mësimet. Kjo nga ana tjetër u reflektua në pagat e punonjësve të këtyre institucioneve. Meqë këtyre institucioneve iu munguan të ardhurat e mjaftueshme financiare, nuk ishte e mundur që punonjësit të paguheshin si zakonisht dhe kishte vonesa në dhënie të pagave.¹¹ Kjo veçanërisht ndikoi te mësimdhënësit zëvendësues dhe ato/ata me kontrata të përkohshme, për shkak të orarit tyre jo të rregullt. Kur bie fjala te vonesa e pagave dhe zvogëlimet e këtyre të fundit, këto institucione pohojnë të i kenë kompenzuar pjesërisht punonjësit e tyre dhe se vazhdojnë të veprojnë ashtu deri në kohën kur situata të përmirësohet pas rihapjes së ekonomisë.¹²

Një numër i madh i punonjësve, me theks të veçantë në institucione private para-fillore, të paktën në fillim të pandemisë ishin tërësisht të varur nga Pako Fiskale Emergjente. Pako Fiskale Emergjente ishte aprovuar nga qeveria Kurti më 30 mars 2020, dhe siguroi, për punonjësit e sektorit të arsimit, një mbulesë të shpenzimeve për pagat mujore, në një shumë prej 170Euro, për muajt prill dhe maj, shumë që arrin një total prej 41 milionë eurosh¹³, si dhe ofroi përfitime tjera për sektorë tjerë të ekonomisë.

Mirëpo, për shkak të situatës së paqëndrueshme politike, me ndryshimin e qeverive, si dhe, sipas Ministrisë së Financave dhe Transfereve, për shkak të një numri të madh të gabimeve të bëra gjatë procesit të aplikimit, nga vetë aplikantët, kishte vonesa të theksuara në implementimin e kësaj pakoje.¹⁴

Duke pasur parasysh që vetë shumica e këtyre ndihmesave nuk është e mjaftueshme për të qenë plotësisht i varur nga ato, vonesa e tyre, përveç kësaj, dëmtoi financiarisht punonjësit e sektorit privat të arsimit. Nga ata më të dëmtuarit ishin punonjësit e këtij sektori të cilët nuk mund të punonin online, duke përfshirë punonjësit e mirëmbajtjes, pastrimit dhe furnizimit me ushqim. Kjo kategori ishte e dëmtuar sepse shërbimet e këtyre punonjësve janë drejtpërdrejtë të

¹¹ Ibrahim, Egzon. International School of Prishtina. Intervistë.

¹² Luta, Fadil. Kolegji Universi. Intervistë.

¹³ Zyra e kryeministrit. (2020). Marrë nga: <https://kryeministri-ks.net/en/approval-of-emergency-fiscal-package/>

¹⁴ Evropa e lirë. (2020). Marrë nga: <https://www.evropaelire.org/a/bizneset-kosova-pakoja-emergjente/30669686.html>

lidhura me prezencen e tyre në ndërtesat e këtyre institucioneve dhe pjesëmarrja fizike e nxënësve në këto objekte, mbyllja e të fundit uli kërkesën për shërbimet e tyre, si rezultat i së cilës, shumica e këtyre punonjësve nuk u paguan gjatë periudhës së mbylljes së plotë dhe kontratat e shumë prej tyre u ndërpritën pa paralajmërim. Edhe pas rihapjes së shkollave, shumë prej këtyre shërbimeve, sidomos shërbimet e furnizimit me ushqim, vazhdojnë të operojnë me staf të reduktuar, sepse masat e qeverisë ndalojnë shpërndarjen e ushqimit nëpër shkolla, prandaj një numër i madh i stafit nuk është më i nevojshëm.¹⁵ Pa pagesa të marra nga institucionet ku punonin para pandemisë dhe ndihmesa të pamjaftueshme dhe të vonuara, nga qeveria, këta punonjës përjetuan krizë të thellë financiare. Punonjësit në të njëjtin sektor, në institucionet publike arsimore dhe në të njëjtën kohë anëtarë të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës e Kulturës, nuk u ballafaquan me të njëjtat probleme financiare, siç është cekur edhe më lartë.

IMPAKTI PROFESIONAL

Fillimi i papritur i pandemisë Covid-19 i detyroi institucionet arsimore të kalonin mësimin në platformat virtuale, tërësisht të papërgatitur. Kur është fjala për impaktin profesional, nga më të ndikuarit punonjës në këtë aspekt, nga ky sektor, ishin mësimdhënësit dhe profesorët. Nga fillimi i implementimit të masave të ndërmarra nga qeveria si mënyrë për parandalimin e përhapjes së koronavirusit të ri, mësimdhënësit e të gjitha niveleve të arsimit, u detyruan të bartnin mësimdhënien e tyre tërësisht në platforma online apo mënyra tjera, brenda një kohe shumë të shkurtër.

Ndonëse Kosova renditet në mes të shteteve në majë të listës, sa i përket kyçjes së shtëpive në internet në Evropë, me 93%¹⁶ të shtëpive në Kosovë që kanë kyçe në internet, përdorimi i të fundit në mënyrë profesionale dhe për mësim online, përbën një pyetje tjetër. Edhe në BE, ku lidhja digjitale nëpër shkolla është fenomen më i shpeshtë se në Kosovë, vetëm 25% e nxënësve, mësohen nga mësimdhënësit që përdorin teknologjinë me vetëbesim të plotë, sipas një raporti nga Banka Botërore.¹⁷

Prandaj, adaptimi në platforma virtuale parashtrroi vështirësi të konsiderueshme për shumë mësimdhënësit. Sa i përket arsimit parauniversitar publik, Minsitria e Arsimit dhe Shkencës së Kosovës, për shkak të situatës së krijuar si pasojë e pandemisë, përgatiti materiale mësimore për mësimin në distancë, të cilat u prezantuan më 23 mars 2020, dhe të cilat materiale do të transmetoheshin më pas në televizionin publik të Kosovës, përkatësisht kanalet RTK1 dhe RTK 4.¹⁸ Shumica e materialit mësimor u transmetua nëpërmjet televizionit kështu që nuk la hapësirë për implementimin e ndonjë planprogrami tjetër individual, prandaj nuk kishte nevojë

¹⁵ Baruti, Egzon. International School of Prishtina. Intervistë.

¹⁶ Eurostat. (2020). Marrë nga: [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Digital_economy_and_society_statistics_-_households_and_individuals#:~:text=By%202019%2C%20the%20share%20of,in%202009%20\(55%20%25\)](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Digital_economy_and_society_statistics_-_households_and_individuals#:~:text=By%202019%2C%20the%20share%20of,in%202009%20(55%20%25).).

¹⁷ Banka botërore. (2020). Marrë nga:

<http://documents1.worldbank.org/curated/en/590751590682058272/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Education.pdf>

¹⁸ Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë. (2020). Marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/article/njoftim-33>

për ndonjë trajnim specifik profesional. Përkundër transmetimit të mësimin në televizion, përsëri kishte nevojë për organizim të mbledhjeve me nxënësit, herë pas here, nëpërmjet platformave Zoom e Google Meet, platforma të cila kërkojnë njohje të konsiderueshme të përdorimit të teknologjisë. Kjo paraqiti vështirësi për disa mësimdhënës sidomos për ata më në moshë, të cilët nuk janë mjaftueshëm të familjarizuar me teknologji dhe utilizimin e saj për mësimdhënie. Rreth 40% mësimdhënësve hasën në vështirësi të niveleve të ndryshme gjatë këtij procesi. SBASHK-u konstaton se, si sindikatë, kanë organizuar nëpër vite, trajnime të ndryshme, për mësimdhënësit e të gjitha niveleve, për t'i familjarizuar këta të fundit me përdorimin e teknologjisë, dhe se vazhduan kështu edhe gjatë pandemisë për t'i mbështetur mësimdhënësit, mirëpo me rezultate përfundimtare jo gjithëherë të kënaqshme.¹⁹

Profesionalisht, evaluimi i evoluimit të nxënësve të arsimit parauniversitar parashtroi vështirësi të konsiderueshme për mësimdhënësit, pasi që transmetimi i mësimin nëpërmjet televizionit pamundëson bashkëveprimin nxënës dhe mësimdhënës. Drejtimi i testeve e provimeve efektive parashtroj nivel të njëjtë të vështirësisë. Ministria synoi t'a zgjedh këtë problem duke i instruktuar mësimdhënësit të bazohen në notat e semestrit para pandemisë për notimin e nxënësve në semestrin e pandemisë, mirëpo për nxënësit e arsimit të lartë kjo ishte e pamundur.

Profesorët universitarë, ligjëratat e së cilëve, i zhvendosën online poashtu, përjetuan vështirësi të konsiderueshme. Shumë prej tyre, sidomos ata/ato më në moshë patën nevojë për asistencë në përdorimin e platformave Zoom, Google Classroom etj.²⁰ Poashtu kishte profesorë të cilët para pandemisë nuk e kishin përdorur asnjëherë teknologjinë në ligjëratat e tyre, andaj mësimi online dhe mungesa e dërrasave të zeza e vështirësoi, profesionalisht, adaptimin e mësimdhënies së tyre në botën virtuale.

Sa i përket edukatorëve të punësuar në institucionet parashkollore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës me ndihmën e UNICEF-it dhe Save the Children lancuan, më 30 prill 2020, platformën e titulluar "Edukimi në Distançë- Kujdesi, Zhvillimi, dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç", për t'i mbështetur e ndihmuar edukatorët të zhvillohen profesionalisht, që në kontekstin e pandemisë, të jenë në gjendje të japin mësimin e përshtatshëm për fëmijët e këtyre grupmoshave²¹. Një video instruktuese ishte mundësuar, poashtu, për edukatorët, që ta mësojnë përdorimin e platformës. Suksesi i implementimit të platformës në institutet parafillore publike e private, ishte i konsiderueshëm.

Situata ishte më ndryshe për mësimdhënësit në institucionet arsimore private. Shkollat private kishin implementuar dhe utilizuar teknologjinë, para pandemisë, në mënyra të ndryshme, në planprogramet e tyre mësimore. Disa prej tyre raportojnë të kenë organizuar teste online, edhe para pandemisë, si dhe të kenë përdorur tabela smart në mënyrë interaktive me nxënësit.

¹⁹ Shatri, Blendor. SBASHK. Intervistë.

²⁰ Luta, Fadil. Kolegji Universi. Intervistë.

²¹ Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë. (2020). Marrë nga: <https://masht.rks.gov.net/article/komunikate-44>

Prandaj, zhvendosja e mësimi në platforma virtuale, ishte më e lehtë, profesionalisht, për mësimdhënësit e këtyre institucioneve.²²

IMPAKTI PSIKOLOGJIK

Masat e ndërmarra si mënyrë e parandalimit të përhapjes së virusit, ndikuan te njerëzit jo vetëm në aspektin financiar e profesional por edhe në aspektin psikologjik. Kufizimi dhe mbyllja në shtëpi, pamundësia për të dalë jashtë, frika nga vdekja dhe sëmundja, ndikuan te njerëzit, në mënyrë negative psikologjike. Sipas një raporti nga UNDP, 28% e pjesëmarrësve në hulumtimin e tyre, raportuan të kenë përjetuar ndikime negative në shëndetin e tyre mendor dhe psikologjik, si pasojë e pandemisë. Ndër më të ndikuarit u raportuan të jenë moshat 25-44 vjeç, ndërsa sa i përket regjionit, Gjakova dhe Prizreni u raportuan si ndër më të ndikuarat.²³ Mësimdhënësit e mbajtën barrën më të rëndë në shëndetin e tyre mendor pasi që atyre i'u desh të mbështesin edhe nevojat emocionale të nxënësve të tyre krahas dhënjes së mësimi gjatë një krize globale. Në këtë mënyrë mësimdhënia online ishte stresuese për ta/to pasi që nuk ishin të përgatitur/a mjaftueshëm profesionalisht. Sipas Qendrës për Ndihmë Psikologjike në kuadër të Departamentit të Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës, shumë mësimdhënës kanë thirrur për ndihmë psikologjike si pasojë e stresit të madh që kanë hasur gjatë mbajtjes së mësimëve online për arsye se nuk ishin mjaftueshëm të përgatitur profesionalisht. Gjithashtu, një numër i madh prej tyre kanë shprehur shqetësimin për stres të madh që kanë hasur gjatë vlerësimit të nxënësve, pasi që transmetimi i mësimi në televizion dhe mungesa e interaksionit nxënës-mësimdhënës, e vështirësoi shumë këtë proces.²⁴ Shumë mësimdhënës, gjithashtu kanë shprehur shqetësimin edhe për stresin e konsiderueshëm të shkaktuar nga prindër që ndërhyjnë në metodat e mësimdhënies dhe mënyrës së vlerësimit të nxënësve nga ana e të parëve. Një numër i lartë i telefonatave, në këtë qendër thirrjesh, kishte ardhur edhe nga mësimdhënës burra, të cilët në një shoqëri dukshëm tradicionale, ku burrat konsiderohen si mbajtës së bukës së familjes, të cilët në mënyrë tipike priten të gjenden jashtë premisave të shtëpisë, nuk mundën të përballonin mbylljen e tyre të tërësishme në shtëpi, gjatë periudhës së izolimit.

Kur bie fjala te ndarja e sferave të punës burrë/grua në një shoqëri tradicionale, ishte edhe një aspekt që thellësisht ndikoi në shëndetin mendor të mësimdhënësve. Shumica e punonjësve në sektorin e arsimit janë gra. Sipas një raporti nga UNDP, ka shumë më shumë gra që punojnë në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, përkatësisht 23%, në krahasim me numrin e burrave që punojnë në po këta sektorë, përkatësisht 8%. Në shtëpinë mesatare, dukshëm tradicionale Kosovare, barra e kujdesit të fëmijëve dhe punëve të shtëpisë, zakonisht bartet nga gratë. Sipas disa raporteve të realizuara nga D4D në ndarjen e përgjegjësisë së kujdesit të fëmijëve dhe punëve të shtëpisë, ndërmjet bashkëshortëve gjatë pandemisë, rreth 30 % e pjesëmarrësve në këto raporte, kanë deklaruar që kryesisht gratë të jenë përkujdesur për fëmijë, ndërsa 38 %

²² Baruti, Egzon. International School of Prishtina. Intervistë.

²³ UNDP. (2020). Marrë nga: <https://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/library/poverty/rapid-socio-economic-impact-assessment-of-covid-19-in-kosovo.html>

²⁴ Halimi, Njomza. Center for Psychological Assistance, University of Prishtina. Intervistë

kanë raportuar për forma të tjera të përkujdesjes për fëmijë. Vetëm 28% e pjesëmarrësve kanë raportuar të kenë ndarë përgjegjësitë në përkujdesje të fëmijëve, gjatë pandemisë.²⁵ Sa i përket ndarjes së punëve të shtëpisë, sipas këtyre raporteve, mesatarisht 1 në 4 burra në Kosovë i ndihmoi bashkëshortes për 0 orë, gjatë pandemisë. Përderisa 47% e burrave të anketuar ndihmuan bashkëshortet për 1-2 orë, 23.7% ndihmuan për 2-4 orë. Vetëm një numër shumë i vogël i burrave, përkatësisht 1.8%, ndihmuan bashkëshortet e tyre deri në 8 orë.²⁶ Duke pasur parasysh faktin e mëparshëm, që shumica e punonjësve në sektorin e arsimit janë gra, mësimdhënëset ishin ndër grupet më të ndikuara psikologjikisht, pasi që presioni i punëve të shtëpisë dhe përkujdesjes ndaj fëmijëve dyfishoi stresin e tyre, dhe përpjekja e balancimit të këtyre detyrave, iu shtoi presion, duke ndikuar negativisht në shëndetin mendor të tyre. Sipas Qendrës së thirrjeve për ndihmë psikologjike të Universitetit të Prishtinës, shumë mësimdhënëse krahas problemeve me dhënen e mësimit online, kishin telefonuar edhe për të shprehur shqetësimin e tyre për vështirësitë që hasnin në menaxhimin e jetës së tyre profesionale ngase në të njëjtën kohë bartnin edhe barrën e punëve të shtëpisë dhe përkujdesjes ndaj fëmijëve të tyre.²⁷

Njëkohësisht, edhe paqëndrueshmëria financiare, në mënyrë të konsiderueshme, ndikoi në shëndetin mendor të punonjësve të sektorit të arsimit, me theks të veçantë te punonjësit në shërbimet e mirëmbajtjes, pastrimit dhe furnizimit me ushqim, pasi që, siç u theksua edhe më parë, shumë prej tyre nuk morën paga gjatë mbylljes totale dhe kontratat e shumë prej tyre morën fund, kështu që një numër i madh nga ta mbetën edhe të papunë si pasojë e pandemisë. Agjencia e Punësimit, vetëm në prill ka regjistruar 32,377 punëkërkuës.²⁸ Me një përqindje shtetërore të papunësisë prej 25,7%²⁹, mbetja pa punë në mes të një pandemie, një e ardhme a paqartë e sigurisë financiare, sjell shqetësim të madh te këta punojës dhe negativisht ndikon në shëndetin mendor të tyre.

Ndihmë psikologjike i është ofruar të gjithë mësimdhënësve të të gjitha niveleve në institutet arsimore publike në kuadër të SBASHK-ut, të cilët angazhuan një skuadër prej tetë psikologëve profesional, të cilët punuan online duke ofruar ndihmë psikologjike për të gjithë të anëtarësuarit në SBASHK.³⁰ Qendra e thirrjeve për ndihmë psikologjike në kuadër të Departamentit të Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës, ofroi ndihmë të konsiderueshme dhe ishte e hapur për të gjithë, përfshirë mësimdhënësit. Shumica e institucioneve private kanë psikologë të punësuar në premisat e tyre dhe raportojnë të kenë ofruar ndihmë për ata që kanë pasur nevojë. Mirëpo stigmatizimi i sëmundjeve mendore dhe shëndetit mendor në përgjithësi, në Kosovë, bëri që kërkesat për këto shërbime të jenë relativisht të ulëta përkundër nevojës së madhe për to.

²⁵ Demokracia për Zhvillim. (2020). Marrë nga: <https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2020/07/2-ALB.png>

²⁶ Demokracia për Zhvillim. (2020). Marrë nga: <https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2020/07/info1ALB.png>

²⁷ Halimi, Njomza. Qendra për Asistencë Psikologjike – UP. Intervistë.

²⁸ Instituti GAP. (2020). Marrë nga: https://www.institutigap.org/documents/97205_covid_tregu_punes.pdf

²⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2020). Marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/media/5412/labour-force-survey-2019.pdf>

³⁰ Shatri, Blendor. SBASHK. Intervistë.

KRAHASIM

Pothuajse e tërë bota ishte e papërgatitur për shpërthimin e pandemisë, kështu që nga fillimi i pandemisë, edukatorët u detyruan që menjëherë ta implementojnë mësimin në distancë, kjo shpesh pa udhëzim dhe përgatitje të mjaftueshme profesionale, problem i përbashkët me shumicën e shteteve.³¹ Edhe pse të dhënat rajonale ndër shtetërore janë të padisponueshme, indikatorë të qartë tregojnë mungesën e kompetencës profesionale të mësimdhënësve, në tërë Ballkanin Perëndimor, që këta të fundit të japin mësim në distancë efektiv për një kohë të gjatë.³² Hulumtimet nga shumë shtete konstatojnë se shumica e sistemeve të arsimit, nuk janë në gjendje t'i furnizojnë mësimdhënësit me mjete efikase, profesionalisht, që ata të jenë të përgatitur të japin mësim në distancë, për një kohë të gjatë.³³

Edhe në BE, ku lidhshmëria digjitale është fenomen më i shpeshtë sesa në Kosovë dhe rajon, vetëm rreth 25% e studentëve mësohen nga mësimdhënës që janë përdorues konfident të teknologjisë.³⁴ Sa i përket nivelit rajonal, megjithatë Serbia ka një kurrikulum specifik të kompetencës digjitale për mësimdhënës, përderisa në të njëjtën kohë kontrollon aftësinë e tyre të përdorimit të teknologjisë gjatë vlerësimit të nxënësve. Në Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut, kompetencat digjitale të mësimdhënësve janë ndër kriteret e kompetencave gjenerale për mësimdhënës, edhe pse kjo nuk qëndron për Bosnjën dhe Shqipërinë (me shumë gjasa edhe për Kosovën)³⁵. Mirëpo, edhe pse në Serbi, për shembull, kompetenca digjitale është pjesë e kurrikulës për mësimdhënës, 56% e mësimdhënësve të anketuar, raportojnë se atyre akoma i'u duhet më shumë zhvillim profesional dhe trajnim në nivele të ndryshme në fushat e ndërlidhura me ICT-në³⁶. Sidoqoftë, adaptimi i tërësishëm në mësimin virtual në distancë dhe utilizimi konfident i teknologjisë tregoi të jetë sfidues, profesionalisht, për shumicën e mësimdhënësve nëpër botë.

Financiarisht, njashtu si në Kosovë, afër dy të tretat e Sindikatave të Arsimit nëpër botë, pjesëmarrëse në një raport të drejtuar nga ISSUU, raportuan se punonjësit e sektorit të edukimit që në mënyrë të konsiderueshme u prekën nga pandemia, ishin punonjësit e sektorit privat të edukimit, me theks të veçantë në mësimdhënësit me orar të pjesshëm në kontrata të përkohshme si dhe punonjësit ndihmës.³⁷ Për shembull, në Sri Lanka ashtu si raportohet të jetë

³¹ UN. (2020). Marrë nga: https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/sg_policy_brief_covid-19_and_education_august_2020.pdf

³² Banka botërore. (2020). Marrë nga: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/590751590682058272/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Education.pdf>

³³ UNDP. (2020). Marrë nga: <https://www.mk.undp.org/content/north-macedonia/en/home/library/poverty/Inclusive-Education-Learning-And-Distance-Learning.html>

³⁴ Banka botërore. (2020). Marrë nga: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/590751590682058272/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Education.pdf>

³⁵ Banka botërore. (2020). Marrë nga: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/590751590682058272/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Education.pdf>

³⁶ Ibid

³⁷ ISSUU. (2020). Marrë nga: https://issuu.com/educationinternational/docs/2020_covid19_survey_report_eng_final

edhe në Kosovë, mësimdhënësit në shkolla private dhe institucione parafillore, nuk u paguan plotësisht sepse nxënësit nuk i kishin paguar pagesat e tyre mujore.³⁸ Gjithashtu 32% gjithashtu raportuan se kushtet e punësimit të personelit ndihmës të edukimit ishin prekur nga pandemia. Njashtu si edhe në Kosovë, pothuajse dy të tretat e sindikatave raportuan se nëpunësit e arsimit parafillor ishin prekur në mënyrë të konsiderueshme financiarisht, si rezultat i pandemisë.³⁹

Që ta parandalojnë keqësimin e shëndetit mendor gjatë pandemisë, shumë shtete integruan ndihmën psikologjike në planet e tyre kontigjente dhe manualet për mësimdhënësit, si dhe shumë OJQ u mobilizuan të ofrojnë mbështetje shtesë. Ndihmë psikologjike u ofrua nga shumë sisteme arsimore nëpër botë si mënyrë për të mbështetur shëndetin mendor të mësimdhënësve, të cilët vazhduan të japin mësim në kohëra të vështira e të pashembullta. Ndërkohë që Kosova vazhdoi me mbajtjen e shkollave të mbyllura si edhe pjesa tjetër e Ballkanit Perëndimor, derisa ato u rihapën plotësisht në shtator, në fillim të gjysëmvetorit të ri, disa shtete, si për shembull Gjermania, rihapën shkollat në fillim të muajit Maj për nxënës që do të testoheshin së shpejti si dhe për ata të ciklit parafillor e fillor, duke implementuar një strategji rotacionale (një javë mësim me prezencë fizike, një javë mësim në distancë), fakt që vendosi punonjësit e këtij sektori në një rrezik më të lartë të infektimit me virus.⁴⁰

³⁸ Ibid

³⁹ Ibid

⁴⁰ <https://www.thelocal.de/20200506/germany-set-to-reopen-all-shops-and-schools-in-may>